



10 Dhjetor 2016
11:00 – 13:00
Qendra tregtare TEG
Tirana

FTESË

Vëri Gishtin Kokës! Jo më Dhunë!

Në kuadrin e fushatës ndërkombëtare të “16 ditëve të aktivizmit kundër dhunës”, me motot “Unë zgjedh të jetoj pa dhunë”, “Vëri gishtin kokës! Jo më dhunë!” dhe “Të kontribuojmë për rastet e dhunës”, Rrjeti “Sot për të Ardhmen” ju fton për t’u bashkuar thirrjes përmbyllëse të fushatës dhe jehonës për të vazhduar më tej kundër dhunës, me të gjithë kontributin që gjithsecili mundet, bashkarisht në Ditën Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut.

Kjo thirrje për t’u bashkuar merr edhe më shumë forcë dhe kërkon më shumë angazhim dhe pjesëmarrje, kur dhuna në familje mbetet një aktualitet i trishtë që rëndohet edhe më shumë nga ngjarjet e njëpasnjëshme të ndodhura së fundmi, madje dhe gjatë kësaj fushate të “16 ditëve të aktivizmit kundër dhunës”.

Thirrja i drejtohet të gjithë qytetarëve dhe aktivistëve të ngrenë fuqishëm zërin nën moton “Unë zgjedh të jetoj pa dhunë”, përfaqësuesve të shtetit shqiptar, agjensive kombëtare dhe ndërkombëtare të jenë edhe më shumë të koordinuar në veprimet kundër kësaj “Vdekjeje të paralajmëruar dhe të palajmëruar” që është shtruar në familjet tona.

Thirrja i drejtohet të gjithë qytetarëve, aktivistëve, përfaqësuesve të shtetit shqiptar, agjensive kombëtare dhe ndërkombëtare, bizneseve etj., që të kontribuojnë me aq sa munden, në çdo formë për të ndihmuar rastet e dhunës në familje dhe për t’u qëndruar pranë në kapërcimin e vështirësive të tyre.

UNË ZGJEDH TË JETOJ PA DHUNË!

Programi bashkangjitur

Kontakt:

Fabiola Egro

Rrjeti “Sot për të Ardhmen”

Tel: +355 230 24 10

Email: info@cdc-tff.org

Për më shumë:

www.facebook.com/albaniancommunitycentre

Me angazhimin e partnerëve:





PROGRAMI

10:00 – 11:00 Himni i Barazisë Gjimore shfaqet në ekranet e TEG

11:00 – 11:20 Thirrja e përbashkët kundër dhunës

Znj. Fabiola Egro - Rrjeti “Sot për të Ardhmen”
Përfaqësues nga Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë
Z. Brian J. Williams – Koordinator i Përhershëm i OKB në Shqipëri dhe
Përfaqësues i Përhershëm i PNUD Shqipëri
Z. Johan Ndisi – Ambasador, Ambasada Suedeze në Shqipëri (tbc)
Mesazhe nga partnerë, të rinj dhe gra, aktivistë të kauzës

11:20 – 12:30 Angazhim i qytetarëve kundër dhunës



Shkrimi i mesazheve kundër dhunës dhe formim i një sfondi masiv (puzzle) nga qytetarët



Pjesë letrare “Mora lule sot” nga të rinjtë e shkollës së mesme “New York High School”, Tiranë



Angazhimi i të rinjve me maska si simbol i të mbijetuarve / mbijetuarave kundër dhunës

12:30 – 13:00 Kontribut në mbështetje të rasteve të dhunës

Shitje të aksesorëve të prodhuar posaçërisht në ndihmë të rasteve të dhunës.
Të ardhurat nga aksesorët e prodhuar nga të rinjtë dhe rastet e dhunës në familje, do të shkojnë në ndihmë të vajzave e grave të mbështetura nga Mekanizmi i Reagimit të Koordinuar kundër Dhunës.

11:20 – 13:00 Shpërnda kontributin tënd!

Përgjatë eventit, ju mund të kontribuoni dhe më tej, duke bërë foto në Puzzle masiv dhe duke e shpërndarë atë në rrjetet sociale!

Statusi: Unë Kontribuoj kundër dhunës!

Hashtag: #UneZgjedhTeJetojPaDhune, #16days, #MMSR, #UNAlbania, #TodayForTheFuture, #SwedenEmbassy, #TEG,

Tags:

www.facebook.com/MinistriaMireqeniesSocialedheRinise,

www.facebook.com/UnitedNationsAlbania

www.facebook.com/SwedeninAL

www.facebook.com/albaniancommunitycentre

Me angazhimin e partnerëve:

